

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Përshëndetje!

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë! Sot jemi duke shqyrtuar projektligjin e ri për shërbimin spitalor, por shqiptarët e dinë mirë, sepse e kanë ende të freskët në memorien se çfarë vështirësish kanë kaluar gjatë kohës së pandemisë. Shqiptarët e prekin çdo ditë shëndetësinë dhe spitalet shqiptare publike, duke paguar nga xhepat e tyre më shumë se çdo popull në rajon dhe në Europë. Rreth 50% e shpenzimeve për ilaçe dhe shërbime spitalore dalin nga xhepat e shqiptarëve. Pse ndodh kjo? Pse shqiptarët paguajnë kaq shumë nga xhepi për ilaçe dhe për shërbime shëndetësore spitalore? Pse shqiptarët zgjedhin spitalet private, të cilat janë më të kushtueshme sesa ato publike, për t'u trajtuar edhe kur ata paguajnë rregullisht sigurimet shëndetësore? Mos vallë shqiptarët janë kaq të pasur?

Në fakt, analiza e kësaj situatë që po ndodh në Shqipëri ka çuar në përfundimin se dy janë shkaqet kryesore pse shqiptarët paguajnë kaq shumë nga xhepi. Së pari, për shkak të përqindjes shumë të ulët që ka buxheti i shëndetësisë në raport me GDP-në e vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe të botës. Së dyti, sepse shërbimi spitalor publik nuk u siguron shqiptarëve plotësimin e nevojave për shërbimin shëndetësor spitalor. Edhe pse janë bërë mbi 30 vjet tranzicion sistemi ynë shëndetësor, ai spitalor, nuk ka funksionuar i integruar si një i tërë, nuk e ka pasur dhe ende nuk e ka në qendër të tij pacientin, shërbimi më i mirë ndaj të cilit duhej të ishte motivi i lëvizjes së motorëve në shëndetësi. Me sloganin “shëndetësia falas” i gënjyet shqiptarët në 2013-n dhe u servirët një shëndetësi që u kushtoi shtrenjtë nga xhepat e tyre. Autonomia spitalore është shumë e vlefshme, por e vonuar.

Pas një eksperience shumëvjeçare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shumë vendeve të zhvilluara europiane sot duhet të kishim mësuar dhe të diskutonim për projekte konkrete dhe se si mund t'i integronim në një spitalet publike, private, sigurimet shëndetësore. Pra, të gjitha këto hallka duhet të ishin të ndërlidhura dhe në qendër të tyre të ishte pacienti, por duhet të kishim diskutuar edhe për një projekt konkret, krahas autonomisë spitalore, e cila patjetër është e vlefshme, se si mund ta bëjmë pacientin qendrën e kësaj strukture integrale ku sigurimet shëndetësore, patjetër edhe pagesat prej tyre, duhet të ndjekin pacientin, aty ku ai do të zgjedhë të marrë shërbimin shëndetësor më të mirin për të. Është absurde që sot në Shqipëri persona me sigurime të rregullta shëndetësore të paguajnë 100% të faturave nga xhepi kur zgjedhin t'i marrin shërbimet shëndetësore në spitalet private, për shkak se këto të fundit ofrojnë shërbime më të mira dhe të specializuara, sepse janë të mirëpajisura me aparatura të teknologjisë së fundit.

Ky projektligj, sipas jush, do t'i kthejë spitalet, pra do t'u japë atyre autonomi në aspektin menaxherial dhe financiar, duke i bërë më efektive, transparente dhe llogaridhënese? A ka shqiptar që e beson këtë? Kush do t'i drejtojë spitalet që do ta fitojnë kartën e autonomisë, kush do t'i përzgjedhë ata dhe mbi çfarë kriteresh do të përzgjidhen këta drejtues? Mbi kritere partiake, siç ka vazhduar dhe bëhet rëndom deri më sot. Po ju bëj një krahasim të shkurtër të ligjit që është bërë 19 vjet më parë mbi të cilin funksionon sot sistemi spitalor në Shqipëri, ai publik, me projektligjin që kemi përpara. Në ligjin e 2013-ës, spitalet, si dhe aktualisht drejtohen nga Këshilli Administrativ, Drejtorja dhe Komisioni Mjekësor, ndërsa sipas projektligjit që po diskutojmë sot spitalet autonome do të drejtohen nga Bordi Drejtues, Ekipi Menaxhues dhe Administratori i Përgjithshëm. A mund të më thotë ndonjë prej jush se ku është diferenca? Sipas mendimit tim, por pa dyshim edhe të shqiptarëve që e dëgjojnë, nuk ka asnjë ndryshim, thjesht fjalë të ndryshuara dhe të modifikuara, por i njëjti thelb i vjetër dhe i ndryshkur.

Klasifikimi i spitaleve publike ishte dhe është aktualisht me këtë ligj që funksionon në spitale ditore, bashkiake, qarku dhe terciare dhe do të bëhet, sipas projektligjit të ri në spitale ditore, bashkiake, qarku, rajoni, terciare dhe Qendra Spitalore Universitare. Besoj se nuk ka shqiptar që ta dijë që ne sot kemi spitale rajonale, si dhe qendra spitalore universitare. Në thelb nuk ka

asnjë lloj diference të ligjit ekzistent, atij të bërë para 19 vjetësh, me projektligjin që na serviret sot. Pa dyshim, një nga risitë, nëse do të arrijë të implementohet, është praktika e dyfishtë e mjekëve. Pra, mjekëve që do të shërbejnë gjatë orarit të punës paradite në spitalet shtetërore do t'u jepet mundësia që të shërbejnë edhe jashtë orarit, pasdite, në ambientet e spitaleve shtetërore për pacientët jashtë sistemit të referimit. Unë shpresoj që kjo gjë të mund të implementohet, të ketë interes nga ana e mjekëve të publikut për ta futur atë në praktikë, por, gjithashtu, të ketë edhe interes të pacientëve për të zgjedhur që t'i marrin shërbimet jashtë sistemit të referimit të publiku, pa dyshim kundrejt një fature që do të përlogaritet, sepse nuk e kemi ende, në raport me privatin.

Ne duhet të ndajmë dy gjëra, faktin që spitalet private i kanë pasur që në krye të herës dhe vazhdojnë të kenë më shumë infrastrukturë në pajisje në raport me shtetin. Meqë po flasim për spitale autonome tek të cilat ne aspirojmë të bëhemi pjesë me anë të këtij projektligji, të cilat do të vetadministrohen dhe vetëmenaxhohen, padyshim jam e sigurt që ky projektligj duhet të ketë parashikuar diçka edhe për sektorin laboratorik, i cili sot është në kolaps total për shkak të papërgjegjshmërisë së koncensionarit dhe garantuesit të tij, pra Ministrisë së Shëndetësisë.

Zonja Ministre, si do të zgjidhet kjo? Do të investohet për laboratorë të rinj dhe do t'ia falim ekzistentët koncensionarit? Do të vazhdohet me sagën e sorollatjeve të pacientëve apo do t'u rikthehen laboratorët spitaleve autonome nesër? Sot në urgjencat spitalore, për pacientët, në shumicën e muajit, nuk kryhet asnjë ekzaminim, të cilat në raste të caktuara mund të jenë edhe jetë të shpëtuar. Unë do ta votoj kundër këtij projektligj sepse nuk është në koherencë me zhvillimin dhe kërkesat e shëndetësisë sot në Shqipëri, por është një bojë që i jepet ligjit të vjetër pa ndryshime thelbësore në atë çfarë synohet të përmirësohet në shërbimin ndaj pacientëve. Ju faleminderit!